



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË**  
**30.11.2022**

Me datë 30.11.2022, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Bledianë Nika, Teuta Zaja, Nersada Mandija, Aurora Dibra, Tereze Brigja, Diana Muriqi, Jona Leqejza, Vjollca Petani, Sabahete Lishi, Daniela Jakoja, Ardita Spahija, Dhurata Tyli, Sabina Danaj, Donika Ndoja, Kristi Agnes Shllaku, Kiara Cubi, Gëzim Galiqi, Erion Metushi, Oltion Luli, Hilmi Lakti, Marjan Ndërshtiqaj, Sokol Zaimaj, Hekuran Gjorretaj, Besmir Vukaj, Anton Deda, Gjergj Sokoli, Andi Halluni, Luigj Palushi, Nadir Spahija.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: *"Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares bashkiake znj. Diandra Kraja".*
2. Pr.vendim: *"Për miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Shkodër për vitin 2023"*
3. Pr/Vendim: *"Për miratimin e vendndodhjes së terminalit të autobuzëve"*
4. Pr/Vendim: *"Për dhënie pëlqimi për pranimin e sponsorizimit nga Ambasada e Republikës së Polonisë Tiranë, në cilësinë e sponsorizuesit për investimin dhe zbatimin e projektit Traffic Toën-Qyteti i vogël i trafikut, sipas projektit të ambasadës së Republikës së Polonisë, Tiranë"*
5. Pr/ Vendim: *"Për dhënie pëlqimi për pranimin e sponsorizimit nga Subjekti Raiffeisen Invest, në cilësinë e sponsorizuesit për investimin dhe zbatimin e projektit rikonstruksion lulishta e Teatrit Migjeni Shkodër, sipas projektit të miratuar nga Bashkia Shkodër"*
6. Pr/Vendim; *"Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin bregdetar të njësisë administrative Velipojë, Bashkia Shkodër"*
7. Pr/Vendim *"Për shtesë në buxheti e vitit 2022, e miratuar me VKB nr.3, datë 5.1.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar"*
8. Diskutime jashtë rendit të ditës

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, por përpara se të vijohet me votimin e rendit të ditës fjalën e merr Znj.Nika, e cila kërkon heqjen nga rendi i ditës i pikës 6 pasi informacioni në relacionin e paraqitur është shumë i vakët.

Z.Dedaj merr fjalën dhe sygjeron që pjesët e paqarta të relacionit në fjalë mund të relatohen nga administrata dhe më pas të kalohet në vendimmarrje.

Znj.Nika shprehet se punonjësit e administratës kanë patur kohë mjaftueshëm për të sjellë një relacion të plotë dhe që përputhet me edhe teknikisht me hartat e vendosura në dispozicion. Ajo mendon të japin kohë Bashkisë Shkodër të paraqesë një relacion të plotë për këtë projekt vendim.

Vijohet me hedhjen në votim të rendit të ditës me propozimin për ndryshim. , ku rezultojnë 30 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

**1.**Mbledhja vijon me Pr/Vendimin *“Për deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares bashkiake znj.Diandra Kraja”*.

Në emër të komisionit relaton Znj.Muriqi sipas materialit të përgatitur. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 31 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

**2.**Vijohet me Pr/ Vendim *“Për miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Shkodër për vitin 2023”*

Kryetarja e Këshillit shprehet se ky është një plan aktiviteteve që i propozohet Këshillit nga kryesia e tij, i cili detajon veprimtarinë e këshillit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 31 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

**3.**Vijohet me pikën 3 të rendit të ditës. Pr/Vendim: *“Për miratimin e vendndodhjes së terminalit të autobusëve”*

Fjala për Z.Koçkiçi, drejtor i drejtorisë së planifikimit në Bashkinë Shkodër, i cili relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Znj.Leqejza në emër të komisionit përshëndet nismën dhe shprehet pro duke theksuar faktin që ky projekt vendim është një lehtësim i madh për qytetarët e Shkodrës.

Znj.Brigja merr fjalën dhe shprehet se Kryetari i Bashkisë duhet të ishte prezent në mbledhje sepse është e disata herë që ai nuk merr pjesë.

Kryetarët e grupeve shprehen pro miratimit duke theksuar rëndësinë e këtij investimi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 31 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

**4.**Vijohet me pikën 4 të rendit të ditës. Pr/Vendim: *“Për dhënie pëlqimi për pranimin e sponsorizimit nga Ambasada e Republikës së Polonisë Tiranë, në cilësinë e sponsorizuesit për*

*investimin dhe zbatimin e projektit Traffic Toën-Qyteti i vogël i trafikut, sipas projektit të ambasadës së Republikës së Polonisë, Tiranë"*

Përsëri relation në mënyrë të detajuar Z.Koçkiçi sipas materialit të përgatitur.

Z.Galiqi shprehet shumë entuziast për idenë e projektit në fjalë, por ka dy pyetje: Sa është vlera e investimit dhe sa do qëndrojë në kohë ky investim?

Përgjigjet Z.Koçkiçi me shifra konkrete sipas parashikimeve të Bashkisë Shkodër, kurse për pyetjen e dytë ai shpjegon se meqënëse Bashkia Shkodër është 1 ndër 3 qytetet përfituese, projekti është i mirëstudiuar dhe ato janë pajisur me çdo detaj të mundshëm për mbarëvajtjen e këtij investimi, por për arsye kohe nuk është paraqitur në relacion. Megjithatë në çdo kohë mund ta vëmë në dispozicionin tuaj. Por ai shton gjithashtu se ky projekt është për Bashkinë një sfidë duke patur parasysh vendin ku do implementohet. Por ky projekt do jetë pjesë e një projekti të madh të financuar nga FSHZH-ja për hyrjen e qytetit.

Z.Vukaj merr fjalën dhe pyet se meqënëse investimi do bëhet në një zonë pak problematike a është menduar nga bashkia për një sistemim të banorëve të asaj zone dhe së dyti a është e sigurt që projekti në fjalë do jetë në sinkron me projektin e FSHZH-së?

Z.Koçkiçi përgjigjet se normalisht Bashkia Shkodër është në sinkron të plotë me FSHZH-në përse i përket projektit të hyrjes së Shkodrës kurse në lidhje me komunitetin e banorëve të zonës aty, ky projekt nuk i prek ato pasi ato janë të vendosur në tokë private dhe projekti do bëhet në tokë publike. Por nuk mund të themi të njëjtën gjë projektin e FSHZH-së.

Znj.Leqejza merr fjalën dhe përgëzon projektin ambizioz dhe vlerëson shumë projektin e hyrjes së qytetit të Shkodrës.

Kalohet në mendimet e kryetarëve të grupeve. Znj.Dibra falenderon Ambasadën e Polonisë për sponsorizimin dhe shprehet pro miratimit. Edhe Z.Sokoli shpreh dakortësi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

**5.** Vijohet edhe me pikën 5 të rendit të ditës. Pr/ Vendim: *"Për dhënie pëlqimi për pranimin e sponsorizimit nga Subjekti Raiffeisen Invest, në cilësinë e sponsorizuesit për investimin dhe zbatimin e projektit rikonstruksion lulishta e Teatrit Migjeni Shkodër, sipas projektit të miratuar nga Bashkia Shkodër"*

Relaton Znj.Hila në mënyrë të detajuar sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjala për Z.Halluni, i cili falenderon për sponsorizimin dhe vlerëson projekt Vendimin duke theksuar domosdoshmërinë e këtij investimi për një qytet culture siç është Shkodra.

Z.Galiqi shprehet edhe njëherë për rëndësinë e projektit dhe thotë se sheshi para teatrit e meriton këtë, por ai mendon se relacioni / informacioni është i mangët. Por shqetësimi i tij

është a mjafton shuma e sponsorizimit për rehabilitimin e këtij sheshi? Parimisht ai është dakort por njëkohësisht edhe shumë skeptik.

Z.Luli ndan të njëjtin shqetësim me parafolësin dhe shton që shqetësues është fakti që rreth teatrit ka nevojë për sistemim, heqjen e parkingjeve dhe tregtarëve rreth e rrotull, të cilët zbehin rëndësinë e këtij institucioni kulturor.

Znj.Hila përgjigjet dhe thekson faktin që ky projekt vendim ka si synim rehabilitimin e krejt sheshit para teatrit, përfshirë parkingjet dhe të gjitha barrierat aty. Do ketë një përmirësim të plotë pamjeje.

Kalohet në mendimet e kryetarëve të grupeve. Znj.Dibra shprehet pro miratimit. Edhe Z.Halluni shpreh dakortësi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

Znj.Kadija propozon që këtij projekti i duhet bërë një prezantim më i detajuar në Poëer Point për të qënë sa më transparent.

6. Kalohet në pikën tjetër të rendit të ditës. Pr/Vendim “*“Për shtesë në buxheti e vitit 2022, e miratuar me VKB nr.3, datë 5.1.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar.*

Fjala për Z.Mema, i cili relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Z. Metushi si anëtar i komisionit të rinisë përgëzon nismën për projekte të tilla që zhvillojnë jetën e rinisë shkodrane.

Kalohet përsëri në mendimet e kryetarëve të grupeve. Znj.Dibra dhe Z.Halluni shprehen pro miratimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

Kalohet në pikën e fundit të rendit të ditës. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Fjalën e merr Z.Palushi, i cili ka një pyetje për zv/Kryetarin e Bashkisë Z.Dedaj në lidhje me dëmtimin e urës në Nj.Administrative Gur i Zi ,fshati Rragam. Ai kërkon të dijë çfarë masash janë marrë dhe çfarë do bëhet për këtë?

Z.Dedaj rithekson dakordësinë që është bërë para dy mbledhjesh në lidhje me pyetjet e këshilltarëve, me qëllim që përgjigjet të jenë sa më të sakta dhe shteruese edhe për publikun edhe për këshilltarët. Ai shprehet së pari se mungesa e Kryetari nuk ka për qëllim në asnjë mënyrë të injorojë kontributin e çmuar të Këshillit bashkiak por vjen si shkak i ngarkesës dhe agjendës së tij, që është caktuar para caktimit të datës së mbledhjes së Këshillit. Së dyti projektet vijnë të vonuara ndonjëherë për mosmbështetje të Ministrisë së linjës për projektet që Bashkia ka aplikuar. Dhe në lidhje me pyetjen e Z.Palushi, ura është dëmtuar nga rreshjet dhe ne kemi provuar përdorimin e një fondi të akorduar nga Emergjencat Civile, i cili kësaj here ka qënë më i vogël dhe i kushtëzuar për tu përdorur për banesat e dëmtuara,kryesisht nga rreshjet. Ai personalisht ka patur një takim me drejtorin e Emergjencave Civile, i cili ka premtuar ndërtimin e një ure ushtarake, që do zgjidhte përfundimisht problemin në fjalë.Ajo mbetet në përparësitë e Bashkisë.

Z.Kadija shprehet se Këshilli Bashkiak është treguar shumë mbështetës me çdo projekt vendim të ardhur në këshill. Gjithashtu ajo kërkon që Këshillit t'i vihet në dispozicion çdo projekt që Bashkia Shkodër ka aplikuar për investim dhe arsyt e mosmiratimit të tyre nga Ministria përkatëse me qëllim që edhe ato mund të llobojnë dhe të kërkojnë mbështetje maksimale.

Z.Dedaj sqaron se ai është dakort që Këshilli bashkiak ka dhënë mbështetje sa herë që i është kërkuar, por projektet e Bashkisë nuk kanë gjetur mbështetjen e duhur dhe si pasojë nuk janë sot investimet e nevojshme në infrastrukturë etj. Dhe kushdo që mund të llobojë për këtë do u bënte nder të gjithë qytetarëve të Shkodrës.

Znj.Brixha edhe njëherë shprehet se mungesa e Kryetarit të bashkisë nuk është e justifikueshme dhe ai të mendojë që në zonën e saj të paktën nxënësit duhet të shkojnë në shkollë te palagur.

Z.Metushi rimerr fjalën dhe shprehet se ai asnjëherë nuk ka bërë dallime politike, por ka nxitur gjithmonë projektet e sjella në Këshill nga Bashkia.

Z.Halluni shprehet në lidhje me situatën e përmbytjeve dhe kërkon të dijë nëse janë rikthyer familjet e dëmtuara në banesat e tyre? Dhe a ka bërë Bashkia Shkodër një komunikim me Ministrinë dhe drejtuesit e KESH-it përse i përket hapjes së digave që gjithmonë del si justifikim. Po steha e qenve kur do jetë gati?

Z.Dedaj përgjigjet në lidhje me emergjencat se ato si Bashki nuk kanë patur asnjë njoftim për shkarkimet e hidrocentraleve. Ministria e linjës dhe Emergjencat Civile kanë sjellë ndihmat për situata të tilla, të cilat janë në formën e fondit të shpërndarjes. Në bazë të vlerësimit të prezencës së ujit është bërë edhe mbështetja me ndihma ushqimore. Kurse familjet e lagura, në dijeninë e tij janë rikthyer në banesat e tyre. Tashmë Bashkia Shkodër ka ngritur komisionin e monitorimit dhe vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet. Kurse përse i përket fondit të Emergjencave Civile ai përsërit që një pjesë prej 4% të tij ka mbetur i papërdorur për shkak të mosdakortësisë Prefekturë-Thesar. Pjesa tjetër do shërbejë për dëmshpërblimet. Kurse në lidhje me stehën e qenve, ajo është në fazë ndërtimi por nuk mund të jap informacion të saktë se kur do përfundojë.

Znj.Leqejza shprehet se ashtu si kolegu Metushi mendon s vërehet si tendencë, dallimi politik i çështjeve në këshill. Ajo risjell në vëmendje që ato synojnë gjithmonë nxitjen e vizioneve dhe projekteve të mirëmbenduara në të mirë të qytetit të Shkodrës. Gjithashtu ajo mendon se Ministrinë nuk është se nuk mbështetin projektet e Bashkisë Shkodër por ndoshta ato mund të mos jenë në lartësinë e duhur për të dal fitues.

Z.Dedaj thotë se ai nuk mendon se nuk ka patur cilësi në projektet e propozuara nga Bashkia sepse shumë të tjerë më pak cilësorë kanë dal fitues dhe kanë marr mbështetje. Megjithatë ai mbetet i hapur për çdo lloj argumenti por nuk duhet të "nxihet" vizioni i Bashkisë Shkodër.

Z.Lakti merr fjalën dhe shprehet se të gjithë duhet të mbajnë përgjegjësitë e veta për mosrealizimin e shumë projekteve që janë miratuar pa mbajtur anën e asnjërit krah politik, pasi këtu të gjithë jemi si qytetar të Shkodrës dhe punojmë për të mirën e qytetit. Kurse në lidhje me përmbytjet, unë jam banor i një zone që përmbytet me pak shi, pa dashur të gjejmë gjithmonë fajtorin, ai mendon se ndonjëherë duhet kërkuar falje për mosndërhyrje në kohën e duhur.

Z.Dedaj shprehet edhe njëherë se ai asnjëherë të vetme nuk ka shprehur rezerva ndaj Këshillit bashkiak por e ka vlerësuar si shumë bashkëpunues në nxitjen e investimeve për Shkodrën. Ai ka përmendur politikisht vetëm rastet kur Bashkia Shkodër ka fituar pak fonde për projekte prioritare për qytetin. Kurse në lidhje me përmbytjet, ai mendon se duhet të lëmë speciaslistat të flasim dhe jo politikën.

Pyetje e diskutime të tjera nuk nuk ka. Kryetarja e Këshillit e deklaron mbledhjen të mbyllur.

*Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 30.11.2022. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).*

*Procesverbali përmban 6 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:*

**Sekretar**

**Denis LESH**

